

Bujqësia në shërbim të zhvillimit



RAPORTI 2016

Prishtina
po bëhet



Vizioni:

Vizioni ynë është për një bujqësi moderne-intenzive, me një proces të integruar të prodhimit, përpunimit dhe plasimit në treg, shfrytëzimit sa më efikas të sipërfaqeve bujqësore, rritjes së sipërfaqeve bujqësore me ujitje, dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të fermerëve.

Për të realizuar vizionin tonë për bujqësinë në komunën e Prishtinës, ne kemi shtuar përkrahjen e fermerëve brenda periudhës trivjeçare, duke përfshirë të gjitha fushat e sektorit të bujqësisë, me theks të veçantë në fushën e perimtarisë, pemëtarisë, lavërtarisë dhe blegtorisë, si edhe krijimin e mundësive për plasimin e produkteve bujqësore në treg.

I. Projektet

	Përfituesit	Vlera/€
1 Përkrahja e fermerëve në perimtari-sera;	52	351,000.00
2 Përkrahja e fermerëve për ngritjen e pemishteve të reja me pemë të imëta-Mjedër;	93	241,800.00
3 Përkrahja e fermerëve për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore;	99	60,484.00
4 Përkrahja e fermerëve në lëmin e shpeztarisë me pula vojse;	27	188,580.71
5 Veterina mobile.		53,756.00

II. Subvencionet

	Përfituesit	Vlera/€
1 Meliorimi i livadheve dhe kullosave;	140	17,150.00
2 Përkrahja e fermerëve për mbjelljen e patates;	107	119,896.00
3 Përkrahja e fermerëve në blegtori;	631	257,464.00
4 Përkrahja e fermerëve në bletari;	288	98,770.00
5 Përkrahja e fermerëve në lavërtari-grurë.	819	259,560.00

Vlera Totale

1,648.460.71

Perimtaria është sektor i rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë në zonat rurale të komunës së Prishtinës. Duke parë gjendjen e rëndë ekonomike të fermerëve dhe mungesën e përkrahjes së mjaftueshme për kultivimin e perimtarisë, Komuna e Prishtinës brenda periudhës trevjeçare të qeverisjes, e ka trajtuar këtë sektor me prioritet.

Si rezultat i përkrahjes së fermerëve për kultivimin e perimeve në ambient të mbyllur gjatë kësaj periudhe trevjeçare, janë punësuar gjithsej 156 persona, me ç'rast janë realizuar të ardhura për këto ekonomi familjare në vlerë prej 260,000.00€

52 fermerë kanë përfituar nga një serrë në sipërfaqe prej 5 arë.





Rajoni i komunës së Prishtinës ofron kushte të përshtatshme për kultivimin e frutave të imëta, si mjedër, dredhëz, manaferrë dhe aroni.

Duke kombinuar kushtet e përshtatshme për kultivimin e këtyre frutave, si dhe gatishmërinë e fermerëve për t'i kultivuar, Komuna e Prishtinës ka përkrahur 93 fermerë për kultivimin e mjedrës.

Si rezultat i kësaj përkrahje, janë punësuar gjithsej **465** persona, me ç'rast janë realizuar të ardhura për këto ekonomi familjare në vlerë rreth **700,000.00 €**.

93 fermerë kanë
përfituar 4000
fidanë mjedër

Komuna e Prishtinës ka mjaft sipërfaqe bujqësore, e cilat nuk po shfrytëzohet sa duhet për kultivimin e kulturave bujqësore. 91 % e sipërfaqes së komunës së Prishtinës është tokë rurale dhe vetëm 9% është urbane. Kjo nënkupton se mundësitë për zhvillimin e bujqësisë janë të mëdha. Për këtë arsye zhvillimi i bujqësisë për ne është prioritet.

Përkrahja e fermerëve për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore

Si rezultat i përkrahje së fermerëve për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore janë rritur sipërfaqet me sistem të ujitjes prej gjithsej 45 Ha.

99

fermerë janë përkrahur
me sistem pikë-pikë të ujitjes,
si edhe me hapjen e puseve.



Përveç, përkrahjes së kultivimit të perimtarisë, frutave të imëta dhe sipërfaqeve bujqësore, Komuna e Prishtinës ka përkrahur edhe fermerët në lëmin e shpeztarisë me pula vojse, bletarisë, blegtorisë, mbjelljen e grurit dhe të patates.

Si rezultat i kësaj përkrahje, fermat kanë arritur që t'i ruajnë kapacitetet prodhuese për prodhimtarinë e vezëve dhe me këtë është ruajtur edhe furnizimi i tregut me vezë të freskëta vendore.

27

fermerë janë përkrahur
me pula vojse

Në lëmin e bletarisë janë përkrahur kategoritë e bletarëve që kanë nga 10-30 shoqëri bletësh, kanë përfituar gjithsej 288 bletarë me gjithsej 5252 shoqëri bletësh.

288

bletarë me 5252
shoqëri bletësh

Në lëmin e mbjelljes së grurit janë përkrahur gjithsej 819 fermerë, të cilët kanë mbjellë prej 1-2 ha me kulturën e grurit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1382 ha.

819 fermerë në mbjelljen e grurit

Në lëmin e meliorimit të livadheve dhe kullosave, janë përkrahur gjithsej 140 fermerë, me nga 150 kg pleh mineral dhe me nga 25 kg bari/fermer. Si rezultat i kësaj përkrahje janë rritur sipërfaqet për 70 Ha.

140 fermerë janë përkrahur me 150 kg pleh mineral

Sa i përket përkrahjes së mbjelljes së patates, janë përkrahur 107 fermerë. Me anë të kësaj përkrahje është arritur prania më e madhe e kësaj kulture në tregun vendor.

107 fermerë janë përkrahur në mbjelljen e patates

Në lëmin e blegtorisë janë përkrahur gjithsej 631 fermerë për gjedhe qumështore, me gjithsej 4098 krerë gjedhe, si edhe 96 fermerë për kafshë të imëta me gjithsej 8060 krerë.

631 fermerë me gjedhe
qumështore janë përkrahur
me 4098 krerë

96 fermerë me kafshë
të imëta janë përkrahur
me 8060 krerë

Veterina Mobile

Me qëllim të preventivës nga sëmundjet e ndryshme infektive, si edhe përmirësimin racor të gjedheve, janë vaksinuar gjithsej 9852 gjedhe dhe 926 qen, kurse janë mbarësuar gjithsej 2104 gjedhe.

